



ROFIX AG 654 INNEN

Ngjitës pllakash C1

Udhëzime teknike dhe ligjore:

Gjatë aplikimit të produkteve tona, respektoni të dhënat në skemat teknike, të cilat janë në përputhje me standardet e përgjithshme dhe specifike të vendit, si dhe të merren parasysh rekomandimet e shoqatës kombëtare të specialistëve.

Fushat e përdorimit:

Ngjitës i hollë sipas EN 12004 për vendosjen e pllakave qeramike në mur dhe në dyshemesë në ambientet e brendshme.

Karakteristikat:

- I patretshëm në ujë

Përpunimi:



Të dhëna teknike	
SAP-Art. Nr.:	2000569260
NAV-Art. Nr.:	132062
Lloji i paketimit	
Njesi per palete	48 Nj./Pal
Sasi për njësi	25 kg/Nj.
Ngjyra	gri
Kokrrizimi	0 - 1 mm
Konsumi	2,0 - 2,3 kg/m ² Mistri me dhëmbëza 6 mm 2,8 - 3,2 kg/m ² Mistri me dhëmbëza 8 mm 3,6 - 4,0 kg/m ² Mistri me dhëmbëza 10 mm
Udhëzime për përdorimin	Të dhënat mbi konsumin janë orientuese, ato varen shumë nga karakteristikat e bazamentit dhe nga teknika e aplikimit.
Konsumi i ujit	ca. 6,75 l/Nj.
Trashësia e shtresës	5 mm
Forca në lidhje (EN 13279-2)	≥ 0,5 MPa
Koha e hapur	ca. 2 h
Gati për bojak	Mur: 12 orë DysHEME: 24 orë
Korigjueshmëria (EN 1015-9)	ca. 5 min
I gatshëm për të mbajtur ngarkesa	7 d
Gati për tu shkelur	ca. 24 h
Koha e përpunimit dhe ngjitjes (EN 1346)	15 min
Grup ngjitës për pllaka (EN 12004)	C1
Certifikata e testimit	MPA - Karlsruhe
Koha e maturimit	5 min
Temperatura e bazamentit	> 5 - < 25 °C

Baza e materialit:

- Çimento
- Rërë e fraksionuar
- Aditivë shtesë për përmirësimin e aftësisë së përpunimit



RÖFIX AG 654 INNEN

Ngjitës pllakash C1

Kushtet e punimit:	Gjatë fazës së tharjes dhe përpunimit, temperatura e ambientit dhe bazamentit nuk duhet të bjerë nën +5 °C. Deri sa të arrihet tharja e plotë, mbrojeni nga ngrirja, tharja e shpejtë (rezatimi direkt i diellit, era) dhe shiu.
Bazamenti:	Dyshemetë me bazë çimento- sulfat, çimento, dysheme me bazë sulfat-kalçiumi dhe betone të vjetra, çimento, gëlqere-çimento, gips, dhe suvatë me bazë gëlqere, për të gjitha llojet e bazamenteve duhet të jenë në përputhje me rregulloret dhe normativat. Dyshemetë me bazë sulfat kalçiumi duhet të paratrajtohen përpara se të shtrohen me pllaka. Kini parasysh lagështinë e mbetur në varësi të bazamentit. Tek suvatë me bazë gipsi dhe gips- gëlqere sipas EN 13279-1, duhet patur kujdes kur lagështia e mbetur është mbi 1%. Bazamenti duhet të jetë i i qëndrueshëm me aftësi mbajtëse, i pastër, pa plasaritje, pa mbetje vajrash, pa lyerje të vjetra dhe mjaftueshmërisht i thatë.
Bazamenti-Trajtimi paraprak:	Për bazamente me aftësi thithëse përdorni astarin RÖFIX AP 300, ndërsa për bazamente kritike shumicën e rasteve ne sugjerojmë fortësuesin RÖFIX AP 320. Parregullsitë e vogla dhe vrimat në sipërfaqe duhet të riparohen me llaçin special RÖFIX FS 630:
Përgatitja:	Përziheni në mënyrë të njëtrajtëshme me makinerinë e përshtatshme, duke i dhënë konsistencën e duhur duke i shtuar sasinë e saktë të ujit. Pas përzierjes respektoni kohën e maturimit, pastaj përziheni përsëri me përzierësin elektrik.
Përpunimi:	Shtrojeni ngjitësin RÖFIX me anën e lëmuar të mistrisë së përshtatshme dhe me anën e dhëmbëzuar vijëzojeni dhe përhapeni mundësisht vetëm në një drejtim. Nëse është e nevojshme, të garantohet një shtrim i pllakave pa hapësira atëherë duhet të aplikohet metoda Floating-Buttering. Mos shtroni më shumë ngjitës se sa mund të shtroni pllaka, sepse kolla humb vetinë ngjitëse. Mistri me dhëmbëza për ngjitës shtresë hollë
Këshilla:	Përzierësit mekanik janë të përshtatshëm veçanërisht për materiale të butë me viskozitet të lartë siç është ngjitësi i pllakave.
Këshilla në rast rezi:	Informacione më të detajuara për sigurinë mund ti lexoni tek skedat tona të sigurisë. Përpara aplikimit të produkteve, jeni të lutur ti lexoni me kujdes këto skeda.
Këshilla për përpunimin:	Materialin i hapur më parë nuk duhet përdorur, gjithashtu mos e përzieni me materialin e ri. Pllakat shtrohen në një shtrat të hollë ngjitësi, duke i levizur lehtësisht dhe mund të korrigjohen brenda pak minutave mbas vendosjes në vendin e tyre.
Magazinimi:	Magazinojeni në vende të thata mundësisht mbi paleta druri. Koha e magazinimit: min. 12 muaj sipas. Rregullores 1907/2006/EG, Aneksi XVII, në temperaturë +20 °C, 65 % lagështi ambientit.
Këshilla të përgjithshme:	Kjo skedë teknike anulon dhe zëvendëson të gjitha versionet e mëparshme. Të dhënat e këtyre udhëzuesve teknike përkohë me njohuritë dhe përvojën tonë praktike të deritanishme. Ky informacion dhe të dhënat janë përpiluar me kujdes dhe me ndërgjegje të plotë, por pa mbajtur përgjegjësi për vendime ose veprime plotësuese që mund të marrë vetë konsumatori. Të dhënat në vetevete nuk provojnë asnjë lidhje ligjore ose detyrime të tjera anësore, dhe normalisht nuk e ndalojnë konsumatorin të testojë produktin për ato qëllime për të cilat edhe është prodhuar. Produktet RÖFIX si dhe të gjitha materialet përbërëse, i nënshtrohen një kontrolli të vazhdueshëm, me anë të të cilit garantohet një cilësi e pandryshueshme. Stafi ynë është i gatshëm tju japë cdo ndihmë teknike në lidhje me përdorimin, përpunimin si dhe mund të ofrojë edhe trajnime praktike në lidhje me përdorimin e produkteve tona. Skedat tona teknike më të reja, me të dhënat aktuale, mund ti gjeni edhe në faqen tonë të internetit (www.roefix.com), ose mund të kërkohen edhe pranë filjaleve rajonale në vënd. Informacione më të detajuara për sigurinë mund ti lexoni tek skedat tona të sigurisë. Përpara aplikimit të produkteve, jeni të lutur ti lexoni me kujdes këto skeda.